



Republika e Kosovës



Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB) –

01.Nr. zyrtar/ 2022

**Procesverbal**

**Takimi i IV-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022**

**Më 31.08.2022**

Në takim prezantuan:

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Sabedin Vishi, Nënkyrytar i Komunës

Halim Shehu, Stacioni i Policisë-Kaçanik

Fatmir Qaka, EVSB

Shemsedin Abazi-KLSP

Elmihane Malsiu-HANDIKOS

Fidaim Fazliu, Bashkësia Islame

Fadil Guri, ZKKK

Vedat Dema, Zyra për të Drejtat e Njeriut

Naim Hysa-Kryqi i Kuq Komunal

Bujar Bajra-Sektori i Emergjencave Civile Komunale

Ylber Tusha-Përfajqsuesi i Bizneseve

Jashar Selimi-Këshilli i Prindërve

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës :

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut
- 3.Masat për parandalimin e lëmoshëkërkuesve
4. Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësin e promovimit të bashkëpunimit , multi-kulturorë dhe ndër – fetar.
- 5.Të ndryshme

1.Procesverbali u miratua nga të pranishmit

## 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut

Për gjendjen e sigurisë në Komunën tonë raportoi Komandanti i Stacionit të Policisë **Halim Shehu** i cili tha se situata e sigurisë në periudhën në mes të dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile por që i kemi gjithsejtë 88 raste ku prej tyre më prekëse kanë qenë 4 raste të dhunës në familje.Lëndim të lehtë truporë-9 raste, lëndim i rëndë truporë -një rast , kanosje- 15raste , dëmtim prone-8 raste , kanosje ndaj zyrtarit kemi një rast , 8 raste të sulmit ndaj qytetarëve , shkaktim i rrezikut të përgjithshëm-3 raste , hyrje në sistemin kompjuterik-një rast , hetim mbi një vdekje e kemi një rast në fshatin Bajnicë , 13 raste i kemi të vjedhjeve të rënda , përdorim i armëve nëpër darsma-3 raste , zjarrvënie – 2 raste , vjedhje në pyje-një rast , mos evitim i rrezikut-1 rast , përdorim i lëndëve narkotike – 3 raste .

Prej këtyre 88 rasteve , 43 janë mbylli dhe janë në prokurori ndërsa rastet tjera janë në hetim e sipër.

Siguria në trafik edhe pse në këtë periudhë kohore ka pasur frekuentim të madh të veturave , ka qenë i mirë.Angazhimi i policorë ka qenë i madh por që ka qenë një ndihmesë e madhe shtimi i vendparkingjve nga komuna .Kemi pasur takime dhe me struktura të shkollave ku kemi biseduar në lidhje me sigurinë nëpër shkolla . Shqetësuese është vjedhja e pyjeve edhe pse në krahasim me vitin e kaluar qëndrojmë më mirë.Kohëve të fundit kemi shtuar realizimin e urdhëresave të gjykatës .

**Kryetari:** nga ajo që u raportua nga komandanti i policisë në përgjithsi qëndrojmë mirë si komunë sa i përkth sigurisë qytetare por që shqetësuese është dukuria e dhunës në familje që është në rritje dhe ne si institucion duhet të angazhohemi që të pengojmë kët dukuri.

**Fidaim Fazliu:** deshta me u ndërlidhë me rastin vdekjes së një fëmiu 4 vjeçar në bunarë në fshatin Bajnicë. Ne si shoqëri në përgjithsi nuk duhet të shfajsojmë vehten ndaj këtyre rasteve por që duhet të angazhohemi dhe të jemi syqelë në parandalim , duke marrë masa paraprake për evitim të çdo situate që sjellë rrezik për qytetarët.Falënderoj zyrtarët policorë dhe prokurorinë që kan bërë një punë të mirë sa i përkth kompetencave të tyre në kët rast , duke ardhur me kohë në

vendin e ngjarjes dhe duke kryer punën e tyre shum profesionale . Një falënderim ju shkon edhe stafit mjekësor të cilët kan qenë të përpikt në kryerje e detyrave të tyre .Shqetësimi im por edhe i familjarëve të viktimës dhe qytetarëve të mbledhur në kët ditë është tek shërbimi i zjarrfikësve .Ndoshta jo për fajin e tyre por që ata e kanë marrë lajmin për një fëmijë i rënë në një bunarë dhe ata në kohë kan ardhur por që asnjë paisje nuk e kishin pasur me vehte ngase të gjitha u mungojshin për të ndërhyrë në kët rast .

Nuk di se ku duhet kërkuar fajtori dhe është për keqardhje që një sektorë kaq i rëndësishëm për çështje të sigurisë të ishte në atë gjendje.Ne si Bashkësi Islame jemi të gatshëm që të ju ndihmojmë këtij sektori dhe me i siguru të gjitha paisjet që ju mungojnë por që institucionet duhet të bëjnë më shumë në trajnimin e këtij stafi për situata të jashtzakonshme si dh të ju krijohen kushtet për punë.

**Krytari:**shërbimi i zjarrfikësve në përgjithsi në Kosovë është në gjendje të vështirë sa u përket kushteve të punës . Ky shërbim nga viti 2012 i ka kaluar niveli qendrorë dhe ne si komunë e kemi në kuadër të shërbimeve publike dhe emergjencave ndërsa rekrutimin e punonjësve dhe servisimin e automjeteve dhe mjeteve të punës e bënë ministria linjë.Ne si shoqëri me iniciativa vullnetare e humanitare mundemi edhe ta ndihmojmë kët sektor por që planifikimet sa i përket anës ligjore i ka niveli qendrorë.

**Fidaim Fazliu:**ne mundmi edhe të i kuptojmë kompetencat por që qytetarët problemin e adresojnë në nivelin lokal ngase problematikat ndodhin nëpër komuna e ata kërkojnë zgjidhje në nivelin lokal.

**Krytari:**punonjësit e këtij sektori mbajnë përgjegjësi nëse neglizhojnë punën duke mos kontrolluar mjetet e punës se a janë në rregull ndërsa ekspertizën për zhytje , trajnime dhe paisjen e sektorit me mjetet të nevojshme pune i takojnë niveli qendrorë.

**Fadil Guri:**ne qytetarëve nuk mundemi të ua tregojmë kompetencat por që në momentin kur njësiti i zjarrfikësve ka kaluar në nivelin qendrorë , ata duhet të interesohen për krijimin e kushteve të punës për kët njësit.Punëtorët e këtij sektori nuk i kan as dosjet e tyre në komunë dhe as nuk i raportojnë komunës për punën e tyre.

Shteti nuk mbahet me ndihma dhe me vullnet të individëve por duhet të veproj në vijë institucionale.Nëse njësiti i zjarrfikësve nuk kan bërë kërkesa për kushte të punës , është përgjegjësia e tyre por ne mundemi të ngrisim si shqetësim por jo përgjegjësi për ta.

**Fidaim Fazliu:**mos të keqkuptohemi me atë që u tha në lidhje me kompetencat dhe për ata zjarrfikës që ishin në gjendje të vështirë në atë situatë jo me fajin e tyre,por që institucionet duhet të sigurojnë kushtet e punës me qëllim që situata të tillë mos të përsëriten.

**Bujar Bajra:** është e vërtet se gjendja e njësitet të zjarrfikësve sa i përket paisjes me mjetet të punës nuk është e mirë.Ky njësit qëndron më mirë në rastet e paraqitjes së zjarreve apo vërvshimeve ngase i kan disa mjetet por edhe janë të trajnuar.Në rastin që ka ndodhur në fshatin Bajnicë , ata janë ndier shum keq , ngase jan lajmruar një orë me vonësë por edhe u kan munguar edhe mjetet e punës për të intervenuar. Ky njësit posedon pompa për zbrazjen e ujit por që nuk janë funksional për thellësi të mëdha.Këto pompa janë vetëm për rastet e vërvshimeve për

të larguar ujin nga bodrumet.Gjithashtu posedojnë boca oksigjeni por që këto boca janë janë të dedikuar vetëm për raste zjarri.Mungojnë trajnime për zhytje , mungan automjeti me korpë dhe shum mjete tjera që u nevoiten në raste të intervenimit në situata të ndryshme.Rekrutimin dhe sevisimin e bënë niveli qendrorë por që kërkesat për krijim të kushteve për punë nuk po mirren parasyshë.

**Fatmir Qaka:**është mirë të punohet në prevntivë që rastet e tillë të mos përsëriten .Të mirren masa paraprake duke hulumtuar në teren dhe të evidentohet çdo gjë që paraqet rrezik për qytetarët.

### **3.Masat për parandalimin e lëmoshëkërkuesve**

**Kryetari:**dukuria e lëmoshë kërkuesve në komunën tonë është prezentë por krahasuar me komunat tjera tek ne është më pak prezentë .Lidhur me gjendjen e kësaj dukurie është mirë që të kemi të dhëna e këtë mundë të na tregoj më në detaile Komandanti i Policisë.

**Komandanti i Policisë:** lëmoshëkërkuesit në komunën e Kaçanikut janë kryesisht nga Shqipëria dhe ne jemi munduar që këtë dukuri ta stopojmë duke lëshuar edhe xhoba që komunat tjera kët gjë nuk e bëjnë.Ne i vëzhojmë ata dhe çdo herë që i hasim i shoqërojmë në stacionin e policisë dhe i përcjellim deri në stacion të autobusëve apo në vendet tjera për të lëshuar territorin e komunës tonë.

**Shemsedin Abazi:**me kët dukuri mirret një rrjet i organizuar të cilët i transportojnë dhe i shpërndajnë nëpër pikat e ndryshme.Policia duhet të e identifikoj kët rrjet për të parandaluar rritjen e lëmoshë kërkuesve.

### **4. Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësin e promovimit të bashkëpunimit , multi-kulturorë dhe ndër – fetar.**

**Kryetari:** është një temë që ndoshta nuk jemi marrë asnjëher por që mendoj se komuna jonë nuk ka etnitete tjera fetare pos atij musliman dhe objektet fetare që egzistojnë në komunën tonë trajtohen nga bashkësia islame por edhe bashkëpunimi nuk ka munguar në aspektin e promovimit dhe sensibilizimit të qytetarëve mbi vlerat e objekteve fetare.

**Fatmir Qaka:**tema ka të bëjë me bashkëpunim multikulturorë , që nënkupton shum kultura.Në komunën tonë nuk kemi etnitete e objekte tjera fetare përpos fesë islame dhe objektet fetare që janë xhamitë.DKRS në natyrën e punës e ka dhe Trashëgiminë Kulturore ku në bashkëpunim me MKRS-në përkujdesemi në promovimin dhe përkujdesjen e objekteve që i takaojnë lashtësisë Lidhur me kët temë zhvillohen aktivitete të ndryshme si në hulumtim , restaurim , trajnim dhe vizita të ndryshme studimore.

## 5.Të ndryshme

**Jashar Selimi:** si përfajqsues i Këshillit të Prindërve dua të dijë lidhur me përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor, që mësimi fillon ditën e nesërme , kur dihet që Sindikata e Arsimit është në grevë , dhe ne si prindër përkrahim kërkesat e mësimdhënësve për krijim të kushteve të punës dhe pagë të dinjitetshme por që jemi kundër bojkotimit të orëve mësimore.Drejtori i Arsimit nuk është këtu por që po ju drejtohem juve Kryetar të na tregoni se si qëndron situata.

**Kryetari:**si institucion kemi bërë të gjitha përgatitjet për një fillim të mbarë të vitit të ri shkollor.Sindikata e Arsimit ka shpallur grevë dhe uroj që qeveria dhe sindikatat të ulen dhe të gjejnë një mirëkuptim për të dalë nga kjo situatë që është krijuar.Pos sindikatës së Arsimit në grevë kemi edhe shërbyesit civil të cilët po e vështirsojnë kryerjen e shërbimit ndaj qytetarëve.Mbajtja e grevës është e drejtë sindikale por që akterët e involvuar duhet të gjejnë një rrugë kompromisi për të gjetur një zgjidhje ngase nga kjo gjendje e krijuar po pësojnë fëmijët dhe gjith qytetarët në përgjithsi.

**Shemsedin Abazi:**kam një kërkesë në emër të lagjës „Idriz Seferi”lidhur me një kanalizim i cili gjatë të reshurave , ujrat e zeza vërshojnë rrugën dhe një kërkesë tjetër që e kam bërë edhe më herët lidhur me vendosjen e një shenje orientuese te Varrezat e Dëshmorëve që i jep orientim stacionit të qytetit.

**Komandanti i Policisë:** para postës është hapur një pusetë që po krijon rrezikshmëri për qytetarët dhe dua të dijë se kur do të intervenohet.

**Kryetari:**lidhur me vërshimin e ujrave të zeza gjattë reshurave është pasojë e ujrave atmosferik të cilat janë bashkë me ata të kanalizimit dhe gypat nuk kan kapacitet për ti përmbledhur të gjitha.Është dukuri në tër Kosovën që është mjaft shqetësuese.Shenjën orientuese te Varrezat e Dëshmorëve shum shpejtë do ta vendosim , ndërsa sa i përket pusetave të hapura është përgjegjësi e komunës dhe do të intervenohet në çdo vend që ka nevojë.

## REKOMANDIMET

- 1.Të ngrisim shqetësimin në nivelin qendrorë në lidhje me kushtet jo të mira për punë për njësitin e zjarrfikësve
- 2.Aktivitete të shtuara në parandalimin e dukurisë së dhunës në familje
- 3.Të punohet në preventivë për të parandaluar situatat që sjellin rrezikshmëri për qytetarët.
- 4.Të parandalohen rrjetet e organizuara që keqpërdorin lëmoshkërkuesit
- 5.Të punohet më shumë në organizim të aktiviteteve që kan të bëjnë me Trashëgiminë Kulturore
- 6.Të vendosen shenja orientuese në të gjitha hapsirat e nevojshme të territorit të komunës
- 7.Të intervenohet në sanimin e të gjitha pusetave që janë të hapura

Kryesuesi: Kryetari i Komunës  
z. Besim Ilazi



Procesmbajtës:  
Fatmir Qaka